



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Shkathtësitë praktike gjyqësore
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve/Semestri:	II-Semestri IV
Numri i orëve në javë:	3+1
Vlera në kredi – ECTS:	6 ECTS
Koha / lokacioni:	Salla A02
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Asoc. Dr Zemri Elezi
Asistent	Phd C. Ahmet Imami
Detajet kontaktuese:	z.elezi@seeu.edu.mk
Përshkrimi i lëndës	Shkathtësitë e praktikës gjyqësore është pjesë e shkencës juridike penale e cila i kontribuon luftës së suksesshme kundër kriminalitetit. Në bazë të plan-programit mësimor të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës në Prishtinë, lënda- Shkathtësitë e praktikës gjyqësore, si lëndë fakultative në vitin shkollor 2016/2017, e cila ligjërohet në semestrin e pestë, përfshinë njësitet e zgjedhura mësimore që lehtësojnë arritjen e njohurive mbi çështjet që i referohen shkathtësive praktike gjyqësore në të gjitha segmentet në të cilat duhet të adresohen problematikat që kërkojnë vendimmarrjen e gjykatës.
Qëllimet e lëndës:	Ky program mësimor mundëson përvetësimin dhe thellimin e njohurive nga Shkathtësitë e praktikës gjyqësore, e cila si pjesë e shkencës juridiko-penale, në kuptimin e gjerë të fjalës i kontribuon luftës kundër kriminalitetit. Programi mësimor nga lënda Shkathtësitë e praktikës gjyqësore, do të shtjellohet në aspektin teorik dhe atë praktik (nëpërmjet ligjëratave, përpilimin e shkresave proceduralo- penale, seminareve, debateve dhe diskutimeve me studentë). Qëllimi i këtij programi është përgatitja dhe aftësimi i studentëve, që si jurist të ardhshëm me lehtësi të përballen me sfidat e zgjidhjes së çështjeve të ndryshme me natyrë proceduralo- penale, të adresojnë çështjet themelore që adresojnë shkathtësi praktike gjyqësore, të përpilojnë me lehtësi shkresat proceduralo- penale, të adresojnë drejtë çështjet që lidhen me kompetencat e gjykatave dhe kështu t'i kontribuojnë luftës parandaluese të kriminalitetit.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Me trajtimin e njësive të caktuara të lëndës së Shkathtësive praktike gjyqësore, studentëve u ofrohet njohuri se çfarë duhet bërë ata si gjyqtarë të ardhshëm që t'i zgjidhin drejtë dhe brenda afateve procedurale problemet me të cilat do të përballen gjatë gjykimit të çështjes penale konkrete. Në sistemin e mësimit zbatohen metodat përkatëse të shtjellimit të lëndës, ashtu që organizohen debate, teste, seminare e kolokviume me qëllim të nxitjes së punës aktive në

	zhvillimin e procesit mësimor. Me këto metoda mësimore, studenti që kryen fakultetin juridik aftësohet me njohuri themelore rreth mënyrës së veprimit të gjykatave në zgjidhjen efikase, të ligjshme dhe të drejtë të çështjeve penale. Vlerësimi i studentit gjatë kohës së ligjëratave bëhet edhe me testim. Kështu, çdo muaj organizohen testet e vlerësimit. Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që: 1. Të kuptojë çështjet që determinojnë shkathtësi praktike gjyqësore gjatë vendimmarrjes lidhur me çdo çështje të shtruar gjatë zhvillimit të procedurës penale, deri të zgjidhja e tërësishme e saj, 2. Të zgjidhë çështjen e kompetencës së gjykatës, provës së papranueshme, vlerësimit dhe çmuarjes së provës etj., 3. Të hartojë shkresa të ndryshme me natyrë proceduralo- penale.		
Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren	1	15	15
Kollokfiume Seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	4	5	20
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	2	5	10
Koha e kaluar në vlerësim	6	1	6
Projektet, prezantimet etj	15	1	15
Totali			195
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata interaktive Krahas ligjërimit të mësimdhënësit, edhe studentët mund të angazhohen, qoftë me komente, pyetje, diskutime apo mendime alternative lidhur me temat që janë objekt i trajtimit në ligjërata;		
Metodat e vlerësimit:	Studentët i nënshtrohen vlerësimit përgjatë gjithë semestrit. Testi gjysmësemestral dhe ai final mbahen me shkrim. Në vlerësimin përfundimtar përfshihet edhe pjesëmarrja aktive në orën mësimore dhe detyrat e shtëpisë. - Testi gjysmësemestral 30% - Testi final 50% - Aktiviteti në orë (seminar, ese, detyre shtëpie, etj)15%		

	- Pjesëmarrja 5% Vlerat e pikëve: Provimi ka 100 pikë. 50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90 = 9; 91-100 = 10 Pikët nën 50, nuk mbërrijnë/përmbyllin notën kaluese.
Literatura	
Literatura bazë:	Hajdari A. Shkathtësitë e praktikës gjyqësore, Prishtinë, 2013, Hajdari A., E drejta e procedurës penale, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2015. Sahiti E. dhe Murati R., E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2014.
Literatura shtesë:	Samaha J., Criminal procedure, Boston, 2014, Rolando V. Criminal Procedure: Law and Practice, New York, 2016, Swanson Ch. Criminal Investigation, London, 2014 Fausto I. E drejta procedurale penale, Përkthim, Tiranë, 2002. Grigor Gj. Procedura penale e RPSH, Pjesa e posaçme, Tiranë, 1970, Grubač M. Krivično procesno pravo, Posebni deo, Beograd, 2004, Hajdari A. Komentar- Kodi i procedurës penale, Prishtinë, 2016,
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	1.Nocioni dhe lënda e shkathtësive të praktikës gjyqësore, 2.Sistemi i lëndës së shkathtësive të praktikës gjyqësore, 3.Parakushtet e manifestimit të shkathtësive praktike gjyqësore.
Java e dytë:	Shkathtësitë e praktikës gjyqësore në lidhje me përjashtimin e gjyqtarëve
Java e tretë:	Shkathtësitë e praktikës gjyqësore në lidhje me vlerësimin e kompetencës dhe bashkimin e veçimin e procedurës penale
Java e katërt:	Shkathtësitë e praktikës gjyqësore në lidhje me aspektet e përgjithshme që ndërlidhen me parashtrësia penale
Java e pestë:	Shkathtësitë e praktikës gjyqësore në lidhje me masat për sigurimin e të pandehurit në procedurë penale, përfshirë hartimin e akteve gjyqësore në lidhje me to
Java e gjashtë:	Shkathtësitë praktike gjyqësore në lidhje me masat për sigurimin e provave materiale në procedurë penale, përfshirë hartimin e akteve gjyqësore në lidhje me to
Java e shtatë:	Kollokfiumi i parë
Java e tetë:	Shkathtësitë praktike gjyqësore në lidhje me çështjet parimore që ndërlidhen me provat
Java e nëntë:	Shkathtësitë praktike gjyqësore në lidhje me provat e veçanta
Java e dhjetë:	Shkathtësitë praktike gjyqësore në lidhje me shqyrtimin e aktakuzës
Java e njëmbëdhjetë:	Shkathtësitë praktike gjyqësore në lidhje me shqyrtimin gjyqësor
Java e dymbëdhjetë:	Shkathtësitë praktike gjyqësore në lidhje rigjykimin e çështjes Shkathtësitë praktike gjyqësore në lidhje me procedurat alternative
Java e trembëdhjetë:	Shkathtësitë praktike gjyqësore në lidhje me mjetet juridike
Java e katërmëdhjetë:	Shkathtësitë praktike gjyqësore në lidhje me procedurat e veçanta

Java e pesëmbëdhjetë:	Rekapitullimi i lëndës
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Studenti është i obliguar të vijojë ligjërata dhe ushtrime. Plagjiatura dhe kopjimi në provime janë të dënueshme sipas statutit dhe rregulloreve të tjera të universitetit. Kodi e mirësjelljes vlen si për studentët ashtu edhe për mësimdhënësit. - Respektimi i orarit të ligjëratave dhe ushtrimeve - Ç'kyçja e telefonave celularë dhe mbajtja e qetësisë në mësim.	